



(albanisch)

Të dashur pacientë,

ne dentistët jemi të gatshëm me kënaqësi që t' ju vizitojmë dhe t' ju mjekojmë. Ju jeni të mirëpritur në ordinancat tona.

Për zhvillimin e një mjekimi është e nevojshme që të mund të komunikoni me dentistin. Një dentist duhet t' ju shtrojë pyetje - për shembull se ku i keni dhimbjet saktësisht, sa kohë i keni dhimbjet apo nëse ju keni një ndjenjë presioni. Përgjigjet tuaja janë të rëndësishme për të konstatuar nga cila sëmundje vuani dhe cili trajtim është i përshtatshëm.

Dentisti duhet t' ju sqarojë mbi këtë mjekim dhe për rreziqet e mundshme të mjekimit. Prandaj është e rëndësishme që ju të jeni në gjendje të tregoni nëse ju, për shembull, keni alergji kundër medikamenteve të veçanta ose ka sëmundje si p.sh. HIV ose hepatit C ose një shtatzëni. Nëse dentisti do t' ju mjekonte pa i marrë këto informacione ose pa ju informuar, ai mund të bëhet i dënueshëm dhe para se gjithash ai mund të rrezikonte edhe shëndetin tuaj.

Pra, nëse ju vet nuk flisni gjermanisht, sillni me vete në mjekim një person që mund të komunikojë me dentistin. Ky person nuk duhet të jetë një përkthyes i kualifikuar, por duhet të flasë dhe të kuptojë gjermanisht në mënyrë mjaftueshme.

Për mjekimin silleni me vete, ju lutemi, fletën e plotësuar për mbledhjen e të dhënave të pacientëve që është e bashkëngjitur.

Ju lutemi, silleni me vete edhe dëshminë tuaj për identitetin si dhe kupon për trajtimin e pacientit. Për informacione mbi fletën për kuponin për trajtimin e pacientit flisni, ju lutemi, me zyrën sociale ose me drejtorinë e institucionit, ku jeni strehuar momentalisht.

Ne do të kujdesemi për ju sa më mirë të jetë e mundur!